

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HËNË 30 MAJ 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sot ne vazhdojmë të diskutojmë për raportimet që bëjnë institucionet e pavarura. Natyrisht, ashtu sikurse edhe në raportimet e tjera, në vend që kjo të ishte një mundësi e jashtëzakonshme për t'i adresuar problemet me sy të pavarur, për fat të keq, siç është vërtetuar dhe vërtetohet vazhdimisht në këtë sallë, kjo nuk është dita për të bërë një analizë kritike, por është një ditë se si maxhoranca i mbron institucionet që i emëron vetë, të cilat nuk janë më të pavarura, por vazhdojnë të mbetet në mënyrë të dukshme leva të partisë. Sigurisht, është një nga momentet më delikate për të reflektuar, një nga fenomenet më negative, më gërryese, një nga ato fenomene që zhbëjnë shtetin, që ka të bëjë me soliditetin e administratës, me mënyrën se si sillet shteti me punësimet në administratë dhe atje ku ofrohen shërbime publike.

Ne vijmë këtu të diskutojmë, gjejmë plot alibi, bajpase për t'i ikur problemit, por shifrat janë kokëforta; janë tronditëse: rreth 130 milionë euro paguhen nga shteti për largimet e padrejta nga puna, pra nga xhepat e shqiptarëve shumë të varfër paguhen 130 milionë euro vetëm e vetëm për atë, që është qëllimi i vetëm: ndërtimi i administratës politike dhe i shpërblimit politik, përtej çdo merite. Sigurisht, në rast se do të kishim një administratë profesionale, eficiente, të qëndrueshme në kohë, ajo nuk do t'u trembej ndryshimeve të qeverisjeve të vendit, sepse e kam thënë vazhdimisht se ndryshimi i administratorëve politikë të radhës nuk ka të bëjë me administratën publike, për të cilën ka pasur investime shumë të madh ndër vite dhe ajo duhej ishte e qëndrueshme. Kush e mban mend, e di që një nga kushtet në atë kohë për të ecur në procesin e integritetit ka qenë ligji i administratës publike, i shërbimit civil, i cili u miratua e u zhbë pak muaj më pas.

Në vend të kësaj qëndrueshmërie, pa diskutim që kemi një administratë shumë të dobët dhe partiake, e cila cilësinë mizerabël të punës së saj e demonstroi në mënyrë të përditshme. Ne si deputetë këtu në Kuvend kemi pasur mundësinë, por edhe maxhoranca duhej të kishte pasur së paku një herë të vetme respekt për veten që të fliste për ato ligje të një niveli mizerabël, për përmbajtjen po se po, por edhe për gjuhën shqipe, me të cilën shkruhen ato, sepse kanë qenë objekt humori edhe në sallat e komisionit, ku

kemi qeshur së bashku, por këtu ndahen frontet, këtu rrëmbehet flamuri dhe budallëkut i gjendet alibi... Nuk e themi ne, por e thonë të gjitha raportet e atyre që na monitorojnë se cilësia është mizerabël.

Pse?! Sepse është një administratë e paaftë. U kanë thanë bravo; u rrahin krahët. "Do të heqim nja 3 të zotë, do të të futim ty dhe do të mbajmë ndonjë të mbijetuar atje që të punojë sa për 7 veta". Kjo është vërteta. Ne kemi një tregues tjetër shumë të rëndësishëm dhe shumë të rëndë. Në rast se do të kishim një administratë që funksiononte, do të krijonte një shtet frymëzues, do të krijonte një klimë biznesi të favorshme e të mirë, do të jepte shtysë dhe, mbi të gjitha, do të krijonte punësim. Kështu, njerëzit nuk do të kishin nevojë ta kërkonin punën e tyre në shtet, por do ta kërkonin pikërisht në sektorin privat, që është edhe motori i ekonomisë. Por çfarë thonë shifrat, jo të miat, të INSTAT-it (dhe jam i qetë dhe besoj se nuk do të ketë marrëzi ndonjë njeri që të bëjë komente për to?!

Në 3 vjetët e fundit punësimi në shtet u rrit me 6,5%, ndërsa punësimi në privat me 2,8%. Po si ka mundësi që kjo administratë vetëm po rritet?! Ka vetëm gllabërim parash, pra ato para që mblidhen, ato taksa që mblidhen, në vend të kthehen në shërbime, kthehen në punësime, në qerasinë pafund. Emrat janë me radhë, janë patronazhistët, njerëz që i lëmë nga mbrapa, të cilëve u rrihet gjoksi i madh. Shyqyr që i kanë patronazhistët, por me çfarë i paguajnë?! Pra, marrin paratë e taksave që paguan biznesi, që paguajnë qytetarët e i kthejnë në vende pune. Po çfarë shërbimesh japin? Mizerabël! E keni në raportin e progresit se çfarë ndodh në pushtetin lokal. Keni konsiderata nga më negativet nga Europa; lëreni opozitën, sepse po u referohemi vetëm atyre që nuk keni çfarë t'u thoni. Çfarë ndodh më tutje?! Më tutje ndodh që i gjithë ky denatyrim, që krijohet për shkak të kësaj administrate, është se asnjëherë të vetme nuk pranojnë dot faktin që administrata duhet të jetë profesionale dhe e depolitizuar.

Këtë nuk e pranojnë dot në asnjë mënyrë. Si do t'ua shpjegojnë qytetarëve shqiptarë që u bë një reformë administrative-territoriale, por është hapur përsëri ky muhabet për të bërë një reformë?! Ndërkohë që nuk është thënë kryesoja, kur u bë ajo reformë (ka prej tyre që janë ministra këtu), që u rra gjoksi dhe u tha se, falë asaj, do të racionalizohen së pari, burimet njerëzore dhe do të kursejmë miliona e miliona dollarë, se do të ulet numri i të punësuarve, sepse nuk kemi pse mbajmë shumë zyra financash, por do të jetë një e vetme në bashki. Kështu u tha, dhe janë thënë në këtë sallë, por jo në rrugë. Çfarë ka ndodhur vërtet?! Jo vetëm që nuk janë pakësuar, por është rritur me 70% numri i të punësuarve, ndërkohë që niveli i kësaj administrate është më mizerabël, sa që janë për t'u bërë duha komunave të dikurshme me këto bashki politike, në pikëpamje të shërbimeve që ofrojnë.

Pra, në të gjitha pikëpamjet, siç e shikojmë, paraja publike shpërdorohet, ka paradokset të tilla, siç u pohua, që ka vrima në administratë, mosplotësime në vende kyçe dhe largime nga administrata, pra njerëz, të cilëve u imponojnë të firmosin dhe të miratojnë procedura, të cilat nuk mund të miratohen, se janë joligjore, sepse e dinë që nesër do të përgjigjen ligjërisht, pra krijohen boshllëqe të mëdha e kërkohen me gëzim të madh cilët janë ata kamikazë të mëdhenj që nuk u trembet syri të firmosin aferat dhe më pas të dinë rrugën se si të fshihen e të ikin nga Shqipëria. Si do të kthejnë përgjigje që një maxhorancë, e cila ka pasur edhe një maxhorancë politike në një qark të caktuar, siç është Vlora, ka ndërruar 14 apo 15 drejtorë hipotetike? A ka faqe më të zeza e më të madhe se kjo?! A ka më këtu justifikime?! A ka ndonjë kurajë që ta justifikojë këtë?

Gjenden kryeministra, gjenden ministra, por nuk gjenden dot drejtorë, sepse duhet kamikazi që fut firmën, u rrëmben pronat e të tjerëve dhe ua jep atyre, klientëve të pushtetit. Kjo është e vërtetë. Ne dalim nga këtu dhe duhet të miratojmë rezoluta, pra t'i futim lustrën e radhës agjitative propagandistike, të mos themi gjë, se gjërat shkojnë si sahat, ndërkohë që kemi në kurriz 130 milionë euro për të paguar për tufën e njerëzve që janë hequr me valë, sepse duhet të paguajmë në prag fushatash 12 mijë, që futen tufa-tufa në administratën publike e paguhen nga taksat e shqiptarëve. Ndërkohë, kuptojmë se administrata punëson dhe biznesi privat, ai që mbush arkën e shtetit, nuk punëson dot, sepse administrata është krijuar vetëm për t'i marrë shpirtin, ta persekutojë, ta gjobisë, jo me gjobën e shtetit, por me atë gjobën tjetër ilegale, e t'i zërë prej fyti.

Ky është momenti i një dramaciteti të jashtëzakonshëm, sepse është një vend, i cili i ka synime të mëdha për t'u integruar në Europë; ka synime legjitime, sepse e kërkojnë shqiptarët këtë gjë, por ka një administratë të shpartalluar, të politizuar dhe thellësisht joprofesionale, pa asnjë shpresë për t'u përmirësuar dhe, praktikisht, i gjithë sektori shtetëror është bërë një rifuxho pekatorum, pra të pazotët, ata që nuk dinë, por që dinë të bëjnë mirë bërjen e qejfit, krehjen e partisë, rrëmbimin e ndonjë vote me lloj-lloj kërcënimesh dhe premtimesh, që mund të rrinë atje dhe të vegjetojnë. Ky është një turp, i cili nuk mund të vazhdojë më, si deri më sot.